

# ANALIZË E SHKURTË POLITIKE, KOSOVË



Konrad  
Adenauer  
Stiftung

## **Energjia – Një qasje praktike në dobi të një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik në Kosovë**

Qershor 2013

[www.kas.de/kosovo](http://www.kas.de/kosovo)

Në këtë studim do të paraqitet një analizë e gjendjet aktuale dhe progresit të deritanishëm në fushën e energjisë në Kosovë dhe efektet e saj në një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Përveç kësaj, do të ofrohen edhe zgjidhje konkrete dhe iniciativa që do të ndihmonin jashtëzakonisht këtë fushë me rëndësi të veçant.

**LULZIM SYLA**

Shoqata e Energjisë së Ripërtëritshme të Kosovës

**SHKURTESAT**

<b>BERZH</b>	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
<b>BB</b>	Banka Botërore
<b>BRE</b>	Burime të ripërtritshme të energjisë
<b>Besëlidhja e Kryetarëve</b>	Lëvizje Evropiane që përfshinë autoritete lokale dhe rajonale, vullnetarisht në dobi të rritjes së efikasitetit të energjisë dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë
<b>EE</b>	Eficienca e energjisë
<b>EREC</b>	Këshilli Evropian për Energji të Ripërtritshme
<b>ESCO</b>	Kompani të specializuara për dizajnim dhe implementim të projekteve në fushën e efijencës së energjisë
<b>EUROSTAT</b>	Agjensioni për Statistika të Evropës
<b>GWh</b>	Gigawat orë
<b>IEA</b>	Agjensia Botërore për Energji
<b>IFC</b>	Korporata Ndërkombëtare Financiare Anëtare e Bankës Botërore
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>KfW</b>	Bankë shtetërore Gjermane për zhvillim
<b>MGW</b>	Megawat
<b>NALAS</b>	Rrjeti i asociacioneve të autoriteteve lokale në Evropën Juglindore
<b>NVM</b>	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
<b>SADC</b>	Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
<b>UP</b>	Univerziteti i Prishtinës

## Parathënje

Ky dokument i përmbledhur i kushtohet në veqanti problemit të energjisë në Republikën e Kosovës e cila që nga pas lufta ka qenë pothuajse faktori kryesor në zhvillimin ekonomik të vendit.

Sot Evropa është para një sfide të madhe që quhet Energjia, e që në vete ngërthen shumë komponente që ndërliken ngushtë me të siq janë: industria, transporti, bujqësia, arsimi, mjekësia, etj. Përveq krijimit të parakushteve për të ndërtuar një mekanizëm që do të krijonte një siguri më të lartë dhe qëndrueshmëri afatgjate të prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike, energjia në vete është edhe një nga faktorët kryesorë të zhvillimit të gjithëmbarshtëm ekonomik të vendeve të Europës. Në bazë të dhënave të fundit nga Eurostat, parashihet rritje e konsumit të energjisë globale me rreth 3% në vitin 2013. Gjithashtu planifikohet të rriten edhe kapacitetet e prodhimit të gazit dhe kërkesa për të parashihet të jetë për 4% më e lartë se në vitin 2012<sup>1</sup>. Ndërsa ndryshimi tjetër do të jetë ulja e çmimit të naftës si rezultat i ofertës më të madhe në treg sesa kërkesës për të.

Sipas raportit të vitit 2012 të "World Energy Outlook 2012" të publikuar nga Agjensia Ndërkombëtare për Energji - IEA, nga viti 2013 deri në vitin 2035 në botë parashihen të investohen rreth 11.8 trilion dollarë në nivel botëror vetëm në fushën e efijencës së energjisë dhe që pritet të rezultojë në: 17.5 trilion në zvogëlim të fakturave për karburante, 50% zvogëlim të ulje të kërkesës për energji në nivel botëror dhe rreth 1.3 trilion dollarë zvogëlim në ndërtim të infrastrukturës së re për energji<sup>2</sup>.

Ndërsa sipas publikimit të fundit nga EREC - "Re-thinking 2050", vizioni i Bashkimit Evropian është që në vitin 2050 furnizimi me energji të bëhet 100% nga burime të energjisë së ripërtitshme.<sup>3</sup>

Në të gjitha hulumtimet që janë bërë me biznese deri më tani në Kosovë, del se energjia elektrike shihet si një prej faktorëve kryesor qoftë në rritje të konkurrueshmërisë në treg kur çmimi i energjisë është i lirë, apo si problem kryesor kur ka mungesë të energjisë elektrike apo reduktime gjatë sezonit të dimrit. Kosova sot ballafaqohet me nevojën për të përcaktuar qartë objektivat zhvillimore me një strategji afatgjate gjë që do të rezultonte edhe në kërkesën reale për energji e cila do të plotësonte nevojat e domosdoshme të amvisërisë, industrisë për një zhvillim të qëndrueshëm. Ky përcaktim do të kishte efekte të mëdha edhe në gjenerim të punësimit dhe mbarë zhvillimin ekonomik të vendit.

Do të fokusohemi në gjendjen aktuale se si qëndron puna me energjinë, investimet që janë bërë në këtë sektorë, infrastruktura e tanishme, importi i energjisë, ndërtimi i kapaciteteve të reja energjetike, burimet e ripërtitshme të energjisë, efijencia në energji, problemet e tjera aktuale, etj.

Ky punim më shumë do të fokusohet në ofrimin e zgjidhjeve dhe propozimeve në fushën e energjisë e sidomos në efijencë dhe në burime të ripërtitshme të energjisë sesa në identifikim të problemeve apo statistikave.

## Energjia dhe Kosova

### Përmbledhje

Për të bërë një përmbledhje të shkurtë pa hyrë në detale të numrave, Kosova përkatësisht qeveritë e saj që nga paslufta nga viti 1999, kanë shpenzuar së bashku me donatorët e jashtëm mbi 1 miliardë euro në riparim të blloqeve të Termocentralit Kosova A & B dhe qindra miliona të tjerë në riparim të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike deri tek konsumatori i fundit, mbi 300 milion janë shpenzimet për blerje të gjeneratorëve dhe derivative përcjellëse nga ana e qytetarëve dhe bizneseve dhe mbi 500 milion euro derivate të shpenzuara për të kompenzuar humbjet e energjisë që ndodhin çdo ditë në vendin tonë. Dhe krejt në fund është importi i energjisë elektrike që na ka shkaktuar humbje me mbi 500 milion euro për këto 14 vite.

<sup>1</sup> Economist Intelligent Unit – The Economist

<sup>2</sup> IEA – Agjensia Botërore për Energji - World Energy Outlook - 2012

<sup>3</sup> EREC – Këshilli Evropian për Energji të Ripërtitshme - [http://www.erec.org/fileadmin/erec\\_docs/Documents/Publications/ReThinking2050\\_full%20version\\_final.pdf](http://www.erec.org/fileadmin/erec_docs/Documents/Publications/ReThinking2050_full%20version_final.pdf)

Përveq problemeve të lartpërmendura, problemet politike me Serbinë vazhdimisht kanë shkatuar dëme financiare si rezultat i keqpërdorimeve nga ana e rrjetit të shpërndarjes së energjisë nga Serbia kur ka pasë nevojë për import të energjisë. Gjithashtu humbjet teknike të energjisë si rezultat i trashëgimit të një infrastrukture të dobët të shpërndarjes së energjisë brenda vendit ka krijuar dëme të mëdha financiare duke ulur në masë të madhe inkasimin e borxheve nga klientët.

Ky është bilanci negativ i mbi 2 miliardë humbjeve janë shkaktuar nga mungesa e një strategjie të mirëfillt dhe të qëndrueshme për energji. Dëmet e shkaktuara dhe vonesat e tilla në implementim të ndërtimit të kapaciteteve të reja siq është Termocentrali Kosova e re apo C dhe burime të energjisë së ripërtitshme, po na bëjnë të varur nga importi dhe po rrezikojmë shumë në dëmtim serioz të industrisë, biznesit dhe në përgjithësi ekonominë e vendit, ku sipas Bankës Botërore mesatarja e dëmtimit të një biznesi nga reduktimet e energjisë elektrike në Kosovë është rreth 2500 euro në muaj<sup>2</sup>.

### **Ku jemi tani**

Në tetor të vitit 2012 Republika e Kosovës ka ridefinuar strategjinë për energji në përputhje me kërkesat dhe direktivat të BE-së dhe kërkesat për integrim evropian. Kosova është anëtare e Komunitetit të Energjisë. Gjithashtu Republika e Kosovës synon arritjen e caqeve 20-20-20 që kërkon Bashkimi Evropian për sektorin e energjisë, që nënkupton e para reduktim të emetimit të CO<sub>2</sub>-shit me 20%, e dyta të rritet me 20% përqindja e burimeve të energjisë së ripërtitshme në konsumin final të energjisë, dhe me 20 % të rritet apo përmirësohet eficientia e energjisë. Ndërsa caku obligativ i Kosovës për BRE dhe EE për vitin 2020 është 25%. Për ti arritë këto synime duhet përkushtim i madh fillimisht nga qeveria, biznesi, dhe nga shoqëria civile.

### **Legjislacioni për Energji**

Sot Kosova në aspektin legjislativ qëndron shumë më mirë se në vitet e kaluara, dhe tani është shumë më afër përmblyljes së legjislacionit që kërkohet

edhe nga organizmat e veqanta në kuadër të Bashkimit Evropian. Republika e Kosovës ka miratuar disa nga ligjet me rëndësi të veqant që hapin rrugën për krijim të një mekanizmi i cili do të krijojë parakushtet për ndërtim të kapaciteteve të reja të energjisë, ofron mundësi për investime të huaja dhe mbi të gjitha krijojnë parakushtet për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Deri më tani janë miratuar:

- Ligji për Energji
- Ligji për Energjinë Elektrike
- Ligji për Rregullatorin e Energjisë
- Ligji për Eficientën e Energjisë
- Ligji për Gazin Natyror
- Ligji për Ngrohje Qendrore, dhe
- Ligji për Paisjet nën Presion

Përveq Strategjisë së Energjisë dhe ligjeve të lartpërmendura, Kosova ka përgaditur edhe rregulloret ligjore mbështetëse për biokarburantët ku sipas direktivës 2009/28/EC edhe Kosova obligohet që 10% të karburanteve në transport të jenë nga biokarburantet në vitin 2020.

Gjithashtu Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është themeluar në qershor të vitit 2004, i cili ka për detyrë të rregullojë aktivitetet në Sektorin e energjisë në Kosovë, përfshirë energjinë elektrike, ngrohjen qendrore dhe gazin, në pajtim me detyrimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë. Edhe tek pjesa e gjenerimit të energjisë nga burime të ripërtitshme dhe eficientës së energjisë Kosova ka avancuar dukshëm duke finalizuar legjislativin e nevojshëm dhe në përputhje me direktivat e KE-së duke ju hap rrugë mundësisë për plotësim të direktivave që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe investimeve të jashtme për BRE dhe EE.

**Infrastruktura Energjetike** - Qeveria e Kosovës me ka privatizuar rrjetin e shpërndarjes së energjisë (KEK) deri në 35 kV dhe tani nga maji i këtij viti menaxhohet nga blerësi i saj me 100% të aksioneve dhe plan të investimit me 300 milion euro për 10 vitet e ardhshme. Bazuar në të dhënat e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), infrastruktura energjetike që ajo menaxhon dhe është përgjegjëse është si vijon përmes Fig.1:

Kapaciteti i Energjisë elektrike nga BRE (MW)								
	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
BRE-EE (MW)								
Energjia fotovoltaike		3	4	6	7	8	9	10
Biomasa solide		2	4	6	8	10	12	14
Era	1.35	31.35	70	90	110	130	140	150
Hidrocentrale të vogla egzistuese	46.21	46.21	46.21	46.21	46.21	46.21	46.21	46.21
Hidrocentrale të vogla të reja		60	140	150	160	180	200	240
Hidrocentrali i Zhurit					305	305	305	305
<b>TOTALI</b>	<b>47.56</b>	<b>142.56</b>	<b>264.21</b>	<b>298.21</b>	<b>636.21</b>	<b>679.21</b>	<b>712.21</b>	<b>765.21</b>

Tabela, Fig.2:

Tensioni (kV)	Numri i linjave	Gjatësia e përgjithshme në (km)
400	6	182
220	13	232
110	45	728
	<b>Totali:</b>	<b>1,142</b>

Përveq kësaj, infrastrukturës elektro-energjetike të Kosovës do ti shtohet këtë vit edhe ndërtimi i kapacitetit të tensionit 400 kV projekt i përbashkët në mes të Republikës së Kosovës, Republikës së Shqipërisë dhe me ndihmë financiare nga Banka Gjermane KfW në vlerë PREJ 75.5 milion euro. Kjo linjë do të lehtësojë në masë të madhe shkëmbimin e energjisë në nivel rajonal.

#### Ndërtimi i kapaciteteve të reja energjetike

Me vendim të Qeverisë së Kosovës dhe me mbështetje të BB-së në vitin 2015 është planifikuar të fillojë ndërtimi i Termocentralit të ri me kapacitet prej 600 MW. Dhe ndërtimi të përfundojë në vitin 2018. Ky kapacitet i ri do të stabilizojë dukshëm furnizimin me energji elektrike për amvisëri dhe industri.

#### Gjendja aktuale me burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe potencialet për investime

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRE) ka caktuar tarifat nxitëse për kapacitetet gjenruese me teknologji të re dhe me paisje të reja. Gjithashtu ka përcaktuar burimet primare të energjisë së ripërtëritshme që përdoren në prodhimin e energjisë elektrike të pranuar në Skemën e mbështetjes dhe janë si në tabelat në vijim.

Tabela nr.2. Paraqet kapacitetin e instaluar të nevojshëm për përmbushjen e Cazeve Indikative për konsum nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, të përcaktuara nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik të Kosovës në (MW)<sup>4</sup>

Ndërsa Tarifa Nxitëse (Feed-in) e aplikueshme për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme dhe të pranuar në Skemën e mbështetjes është si vijon në tabelën fig.3:

Burimi primar i energjisë së ripërtëritshme	(€/MWh)
Hidrocentralet (<10MW)	63.3
Era	85.0
Energjia solare	j/a
Biogazi dhe Biomasa	71.3

<sup>4</sup> Zyra e Rregullatorit të Energjisë



**Prioritet i prioriteteve** Edhe pse në Kosovë viteve të fundit është diskutuar shumë për energji duke mos arritë që të ketë një mirëkuptim cilësor mes shoqërisë civile, qeverisë dhe lobimeve të ndryshme

nga mbarë bota, prioriteti i të gjitha prioriteteve do të duhej të ishte furnizimi rregullt dhe i qëndrueshëm i qytetarëve me energji elektrike, ndërsa të gjitha elementet e tjera janë sekondare dhe të zgjidhshme.

### Parashikimi i kërkesave dhe prodhimit të energjisë në raport me zhvillimin ekonomik

Bazuar në Stretgjinë e Energjisë janë paraparë tre skenare të zhvillimit të kërkesave në raport me zhvillimin ekonomik të vendit. Ndërsa, sipas skenarit të lartë të kërkesës (SLK) për energjinë elektrike, konsumi në vitin 2018 parashikohet të jetë 7,431 GWh/vit, kjo e shoqëruar me ngarkesë maksimale prej 1,671 MW<sup>5</sup>. Kjo ndërlidhet ngushtë me atë se si qeveria i ka parapri një zhvillim jo të qëndrueshëm për 15 vitet në vazhdim dhe atë duke e cilësuar si skenarë të lartë të zhvillimit, ku rritjen ekonomike e parashohin mes vlerave 3 % deri në 5.2% rritje ekonomike në baza vjetore e që për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik është shumë pak dhe kjo më tepër duket sikur një përshtatje e vlerave të konsumit në raport me prodhimin e energjisë se sa një analizë e sakt mbi trendet e rritjes së kërkesave për amvisëri dhe industri.

Figurat 1 dhe 2 paraqesin parashikimin e kërkesës për secilin sektor dhe totalin e saj. Nga Figura 1 duket se kërkesa e energjisë për secilin sektor ekonomik do të rritet.



<sup>5</sup> Strategjia e Energjisë të Republikës së Kosovës 2009-2018

## Rekomandimet

Për implementim të strategjisë së energjisë, kërkohet zbrëthim i projekteve që dalin nga kjo strategji. Përpilimi i këtyre projekteve dhe zbatimi i tyre kërkon një fond financiar të veçant mbështetës. Krijimi i një fondi zhvillimor prej anës së qeverisë për promovimin e produkteve dhe shërbimeve që ndikojnë në zhvillimin dhe aplikim të projekteve në këtë segment. Ky fond do të duhej të përdorej edhe për stimulim për hulumtim të projekteve zhvillimore dhe nxitjen e inovacioneve në fushën e energjisë së ripërtitshme.

## Heqja e taksave dhe subvencionimi i familjeve dhe bizneseve për prodhim të energjisë së ripërtitshme dhe efijencë

Për të nxitë sadopak qytetarët dhe bizneset për të implementuar masat e efijencës së energjisë dhe për të prodhuar energji nga burime të ripërtitshme duhet të hiqet dogana dhe TVSH-ja të paktën për disa vite për të nxitë përdorimin dhe edukimin për këto masa, sepse edhe ashtu deri më tani buxheti i shtetit ka përfutuar shumë pak nga ky segment sepse nuk ka pasë import të tyre, ku një nga arsytet ka qenë edhe çmimet e larta. Produktet që do të jepnin efekt direkt janë: materialet e ndërtimit me efijencë të lartë, panelet fotovoltaike, panelet termike për ngrohje të ujit sanitar, ngrohjet qendrore me pelet, poqat ekonomike (fluoroshente kompakte), kompenzatorët e energjisë për industri, etj. Praktika e zhvillimit të këtyre projekteve kryesisht bëhet në bashkëpunim me bashkëpunim siq janë organizatat botërore që mbështesin programet për energji dhe efijencë siq janë BERZH, Banka Botërore, IFC, apo edhe segmnete tjera që mbështesin këto projekte që dalin si projekte nga fondet e Komisionit Europian siq janë: "Intelligent Energy Europe",

## Edukimi, përgaditja e kuadrove të reja në sektorin e energjisë

Kosova edhe pse vlersohet me popullsi në moshë të re, ajo vuan nga mungesa e mirëfillt e edukimit dhe zhvillimit të resurseve humane për treg të punës. Raporti i fundit "Energjia e Ripërtitshme si shans i Zhvillimit Ekonomik në Kosovë" punuar nga GIZ dhe kompania Evro Energji në Prishtinë në vitin 2013, dalin të dhëna shumë interesante dhe me mundësi shfrytëzimi për gjenerim të punësimit nëse investojmë dhe reagojmë shumë shpejtë në krijim të inxhinierëve dhe teknikëve të rinj që do të ishin të gatshëm për aktivizim në industri të prodhimit të pjesëve makinerike, elektrike, elektronike dhe shërbimet përcjellëse për liderët botëror të energjisë, EE dhe energjisë së ripërtitshme. Në këtë drejtim pasiqë Kosova të vetmen mundësi zhvillimi e ka aktivizimin e

industrisë, përgaditja e departamenteve të reja për energji, energji të ripërtitshme dhe efijencë në kuadër të Univerzitetit duke përgaditë edhe kurikulat përkatëse e krahas kësaj edhe e njëjta punë të bëhet edhe me shkolla profesionale duke i pajisur edhe me laboratorë dhe punë praktike, do të bënte që vendi ynë të gjenerojë me mijëra vende pune në shërbim të këtyre segmente të industrisë. Sa për ilustrim të gjendjes se sa keq jemi me resurse humane, përkatësisht me inxhinier të profileve energjetikë, elektrikë, elektronikë dhe makineri, është gjendja në Fakultetin e Elektroteknikës ku në mungesë të kuadrove të reja si asistentë dhe profesorë brenda 5 viteve mund të rrezikon të mbyllet si katedër kur kemi parasyshë se shumica e profesorëve janë mbi 60 vjet. Ndërsa në anën tjetër kemi ndërtimin e termocentralit të ri "Kosova e re" e cila edhe pse nuk ka analizë detale se ka kërkon njerëz të kualifikuar, për të zhvilluar punën me cilësi nevojiten minimum 300 inxhinier sepse pothuajse shumica e proceseve janë të digjitalizuara e që Kosova nuk i ka këta inxhinier ose duhet ti marrin nga bizneset private ose nga jashtë me një kosto shumë më të lartë. Gjithashtu fakulteti i makinerisë në UP duhet të shpejtojë në ndërtim të kapaciteteve për të hapur drejtimin e ri për studime në EE dhe BRE. Krijimi i një fondi për hulumtime shkencore dhe zhvillimore do të krijonte mundësinë që studiues të rinj dhe ekspertë të fushave të energjisë të merren me projekte ku kërkesa për analiza në këto fusha për momentin është në ekspansion në tregun botëror.

## Themelimi i Institutit për Energji dhe Efijencë

Ky institut do të duhej të themelohej nga Univerziteti i Prishtinës në bashkëpunim me Qeverinë e vendit dhe do të merrej me zhvillimin e politikave të energjisë dhe efijencës. Gjithashtu në kuadër të këtij institucioni do të duhej të themelohej edhe Këshilli Kombëtar për energji dhe efijencë që do të kishte për detyrë kordinimin e projekteve dhe aktiviteteve në mes ministrive, komunave, industrisë për qëllim të promovimit të zhvillimit të projekteve në fushën e ndërtimeve të gjelbërta që lidhet ngushtë me konsumin e energjisë dhe efijencës së saj. Ky propozim për këtë Këshill në Evropë njihet si "Green Building Council".

## Auditorët e Energjisë

Kosova momentalisht ka 52 auditorë të certifikuar të energjisë. Ky numër i auditorëve nuk mjafton për menaxhim të suksesshëm të auditmit të të gjitha objekteve të institucioneve publike e lere më për ato private. Krahas përgaditjes së resurseve të reja për energji dhe efijencë, në Kosovë ka nevojë edhe për mbi 50 të tillë kur kemi parasyshë se në çdo komunë të Kosovës duhet të egzistojë minimum nga një zyrtarë për EE dhe BRE e cili do të hartojë politikat e komunës

dhe të zbatojë ato në kordinim me strategjinë e energjisë së vendit dhe kërkesave të KE-së.

### **Ligji i Ndërtimit - Objektet e Gjelbërta dhe Auditimi**

Implementimi i projektit për çertifikimin e objekteve ndërtimore si efijente (materiale të ndërtimit, sistemet për ngrohje, ftohje dhe energji elektrike – auditimi i energjisë në ndërtesa) të cilat si masë stimuluese do të kishin lehtësira fiskale varësisht nga niveli i implementimit. Kjo do të duhej që të integrohet në Ligjin e ndërtimit përmes përcaktimit të niveleve të çertifikimeve ku fillohet me kuotat minimale të përcaktuara sakt dhe deri te nivelet e përcaktuara më të avancuara të ndërtimit në masën 100% ndërtim efijent duke ju referuar Planit Nacional të Veprimtimit për Efijencën e Energjisë në kordinim me Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor duke stimuluar që përmes përcaktimit të kuotave të krijohet edhe mekanizmi i lehtësirave tatimore dhe pagesave për ndërtime dhe renovime. Niveli i implementimit të këtyre kuotave do të duhej stimulohej edhe në pagesa të taksave për leje ndërtimore. Implementimi i këtyre masave do të krijonte një zingjirë shumë të mirë të rritjes së kompanive që merren me produkteve dhe shërbimeve për EE dhe BRE.

### **Potenciali për zhvillim të biznesit nga sektori i energjisë dhe efijencës në Kosovë**

Edhe pse në Kosovë viteve të fundit janë bërë disa hulumtime në fushën e prodhimit të energjisë e sidomos energjisë nga BRE-të, prap nevoja për krijimin e atlaseve të erës, diellosjes, dhe ujërave është e domosdoshme dhe do të krijonin një potencial për thithje të investimeve të jashtme. Hulumtimi i fundit i bërë nga Evro Energie<sup>6</sup> në bashkëpunim me GIZ mbi potencialet e energjisë së ripërtitshme nxjerrë të dhëna interesante për BRE-të sidomos në fushën e energjisë nga era, ku vetëm në Kosovë sipas një hulumtimi tjetër të bërë nga një kompani Zvicrane del se se kapaciteti i prodhimit të energjisë me erë në Kosovë është rreth 300 MGW<sup>7</sup>. Por nga ky hulumtim ka disa të gjetura shumë të mira për nxitjen e aftësisë konkurruese në sektorin e biznesit, ku në këtë pikë do të fokusohem më shumë. Kosova vuan tash sa vite nga mungesa e prodhimit industrial dhe si rezultat vlerës së vogël të eksporteve që të dyjat janë si parakusht kryesor për një gjenerim të lartë të punësimit në Kosovë. Nga raporti del se në rast të implementimit të investimeve në fushë e energjisë së erës mund të gjenerohen edhe qindra vende të reja të punës vetëm nga ky sektorë duke ndërlidhur një numër të

konsiderueshëm të kompanive që kryejnë shërbimet përcjellëse duke krijuar vlerë të shtuar siq janë: kompanitë për prodhimin e paisjeve dhe komponentëve të ndryshme elektrike, mekanike, elektronike etj, pastaj kompanitë e operimit, planifikimit, instalimeve dhe servisimeve. Por gjithashtu nga ky raport del se deri në vitin 2030 parashihen të ndërtohen mullinjë të ri të erës dhe do të prodhohen edhe rreth 872 mijë GWh energji elektrike nga era. Kjo do të gjenerojë rreth 794 mijë të punësuar nëpërmjet energjisë së erës dhe për këtë arsye nëse Kosova din ti shfrytëzojë potencialet që do të ndërtohen në vitet në vazhdim në gjithë botën do të mund të krijoheshin me mijëra vende tjera pune duke inkuadruar përsëri kompanitë e sipërpërmendura.

Gjithashtu hulumtimet në fushën e efijencës së energjisë janë shumë të dobishme për të nxjerrë vlerësime të mëtutjeshme rreth dizajnit të programeve mbështetëse në fushën e efijencës së energjisë qoftë në amvisëri apo industri.

Rëndësi të veçantë ka edhe anëtarësimi i Kosovës në organizmat botërorë që merren me fushën e energjisë së ripërtitshme, mbrojtjes së ambientit, rritjes së efijencës etj.

Përgatitja e projekteve për reduktim të përdorimit të automjeteve në trafik që krijojnë ndotje të lartë duke eliminuar automjetet e vjetra dhe zëvendësimi i tyre përmes implementimit të projekteve në fushën e transportit publik.

### **Bashkëpunimi me komunitetin e biznesit**

Për të implementuar me sukses strategjinë e energjisë, Qeveria e Kosovës përfshi ministritë, komunat dhe agjensionet tjera që merren me energji, EE dhe BRE duhet të bashkëpunojë ngushtë me komunitetin e biznesit përmes asociacioneve dhe odave ekonomike të vendit e që për fat tashmë kemi edhe asociacione të biznesit që merren direkt me energji, EE dhe BRE siq është SHERK<sup>8</sup> dhe AKEREE<sup>9</sup> të cilat kanë një numër të madh të bizneseve dhe ekspertëve të fushave përkatëse e të cilat do të ndihmonin jashtëzakonisht shumë në implementim të suksesshëm të strategjisë duke dhënë kontributet e tyre profesionale dhe praktike.

### **Themelimi i ESCO Kompanive**

Një ESCO (Energy Service Company) është një biznes që zhvillon, instalon dhe rregullon financimin për

<sup>6</sup> Energjia e Ripërtitshme si shans i zhvillimit ekonomik në Kosovë. Viti 2012, punuar nga Evro Energie dhe GIZ  
<sup>7</sup> NEK UMWELTTECHNIK AG, Zvicër 2012

<sup>8</sup> SHERK – Shoqata për energji të ripërtitshme e Kosovës  
<sup>9</sup> AKEREE – Asociacioni Kosovar për burime të renovueshme të Energjisë dhe Efijencës të Energjisë



projektet që dizajnohen ta përmisojnë eficiencën e energjisë. ESCO-t në përgjithësi veprojnë si zhvillues të projekteve për një gamë të gjërë të detyrave dhe konsiderojnë rrezikun mbi performancën që lidhet me projektin.

Shërbimet që ato ofrojnë janë:

- Zhvillimi, dizajnimi dhe rregullimi i financimit për projektet e energjisë efikente
- Instalimi dhe mirëmbajtja e paisjeve të përfshira për projektet e energjisë efikente
- Matja, monitorimi dhe verifikimi i kursimeve të energjisë
- Supozimi (marrja për sipër) e rrezikut se projekti do të rezultojë me kursim të energjisë

Mbështetja në Themelimin e këtyre kompanive kërkohet edhe nga marrëveshja që del nga **Komuniteti i Energjisë**. Këto kompani do të ndikonin shumë në mbarëvajtjen e proceseve dhe dizajnimin e raporteve mbi konsumin e energjisë dhe veqanarisht në implementim të eficiencës së energjisë tek familjet dhe bizneset-industria.

### Java Evropiane e Energjisë

Ky është një projekt që mbështet çdo vit nga Bashkimi Evropian për promovim të energjisë, burime të ripërtitshme të energjisë, edukimit të qytetarëve, bizneseve dhe qeverisë në përdorim më eficient të energjisë dhe uljes së emetimit të gazrave të CO<sub>2</sub>-shit. Ky projekt do të kishte efekt jashtëzakonisht të madh sikur të organizohej edhe në Kosovë që nga viti i ardhshëm 2014. Nëse ne kemi interes dhe jemi të vendosur, edhe pse nuk jemi anëtar të BE-së, besojë se nuk do të mungonte mbështetja e tyre në organizim të këtij aktiviteti që do të kishte efekte të shumë anshme, duke filluar nga mbjellja e pemëve të reja, organizimin e aktiviteteve edukative në shkolla fillore dhe të mesme, organizim të aktiviteteve për kursim të energjisë, etj.

### Energjia në nivel komunash

Ndryshimet dhe zhvillimet në vitet e fundit në sektorin e energjisë dhe të mbrojtjes së ambientit, duhet të bëjë komunat të jenë më të vetëdijshme rreth detyrimeve dhe kërkesave që dalin për zbatim të masave të eficiencës përmes burimeve të energjisë së ripërtitshme. Ky ndryshim duhet të fillojë nga vetë objekti i komunës duke filluar nga ndërrimi i sistemit të

ngrohjes dhe ftohjes ku shumica e tyre janë me naftë, pastaj ndriçimi në zyre e pastaj të fillohet me objekte të tjera që janë nën administrimin komunal si shkolla, ambulanta, kopshte fëmijësh, etj. Për implementim dhe shkëmbim më të mirë të praktikave të zhvillimit të projekteve në nivel komunash do të ishte shumë e rëndësishme anëtarësimi i komunave të Kosovës në Besëlidhja e Kryetarëve (**Covenant of Mayors**) është iniciativë Evropiane për përfshirjen e autoriteteve lokale dhe rajonale, vullnetarisht në projekte për të rritur efikasitetin e energjisë dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtitshme të energjisë në territoret e tyre. Gjithashtu është me rëndësi të veçantë të punohet në drejtim të pavarësisë dhe eliminimit të ndikimit të drejtpërdrejtë në furnizim me energji elektrike nga qendra. Gjithashtu një ndër rrjetet më të mëdha të Evropës Juglindore që komunat e Kosovës duhet të bashkëpunojnë në shkëmbim të praktikave më të mira për implementim të masave të eficiencës së energjisë është NALAS-<sup>10</sup>.

Pavarësisht nga ajo se nga BE-ja nuk e kemi me obligim përmbushjen e kuotave "20-20-20", 20% në ulje të emitimit të gazrave CO<sub>2</sub>, 20% rritje të eficiencës në përdorim të energjisë dhe 20% tjera në rritje të kapaciteteve të reja me energji të ripërtitshme deri në vitin 2020, por e kemi me rekomandim, ne duhet vetë të analizojmë raportin e përfitimeve, shëndetin e qytetarëve dhe benefiteve apo kostove të tjera që rrjedhin si rezultat i implementimit të këtyre projekteve përkatësisht kuotave në energji të pastër. Për të pasur efekt në implementim duhet të parashihen gjithësesi edhe përgaditja e materialeve për vetëdijësim të publikut.

### Fondet ndërkombëtare për energji dhe eficiencë

Për të realizuar rekomandimet dhe projektet e sipërpërmendura qoftë në implementim të projekteve në fushën e amvisërisë, NVM-ve, themelimit të ESCO kompanive, komunave apo edhe aktiviteteve në sektorin publik duhet që ne në kordinim me ligjislacionin për energji dhe eficiencë nevojitet që institucionet përkatëse të përgadisim projektet e tilla të cilat dalin nga ligjet që kemi krijuar dhe të kërkojmë fonde për zhvillim të këtyre projekteve tek fondet ndërkombëtare siq janë: Green for Growth, Open Regional Fund, IPA, FEEI, etj, të përkrahura nga

<sup>10</sup> NALAS-i është rrjet i asociacioneve të autoriteteve lokale në Evropën Juglindore.



donator të ndryshëm si: USAID, SIDA, GIZ, KFW, BB, BERZh, UNECE, SADC, etj. Pavarësisht se nuk jemi anëtarë të Bashkimit Evropian, ne duhet të jemi më insistues në pjesmarrje të fondeve të BE-së përmes përgaditjes së projekteve ambicioze sidomos për energji dhe eficiencë.

### **Përmbledhje**

Synimi i këtij punimi ka qenë përmbledhja e disa elemente me rëndësi në fushën e energjisë , EE, dhe BRE-ve që duhet të ndërmerren si veprime nga institucionet qendrore dhe lokale në Kosovë, të cilat do të rezultojnë me përmirësimin e gjendjes në përgjithësi në fushën e energjisë në të gjithë sektorët e ekonomisë, si dhe në rritjen e vetëdijësimin për rëndësinë e trajtimit të disa problemeve që nuk guxojmë ti harrojmë gjatë viteve në vazhdim sepse mund të na kthehen bumerang në planifikim, zhvillim dhe implementim të strategjisë së energjisë në nivel kombëtar. Sidomos ndërtimi i kapaciteteve dhe planifikimi paraprak i resurseve humane adekuate për secilin sektorë do të lehtësonte shumë hartimin dhe implementimin e projekteve që ndërlidhen me sektorin e energjisë.

Sot në Bashkimin Evropian energjia konsidohet si një prej shtyllave kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vetë BE-së, prandaj kordinimi i aktiviteteve dhe zhvillimi i projekteve në harmoni me direktivat e KE-së do të na ndihmonin shumë të përfitojmë nga ky zhvillim në arritjen e caqeve të përcaktuara të cilat na afrojnë shumë me BE-në.

**Pikëpamjet e shprehura në këtë punim janë pikëpamje personale të autorit dhe ato nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit-Konrad-Adenauer.**

### **Kontakti:**

#### **Konrad-Adenauer-Stiftung**

Zyra në Kosovë  
Bul. Nëna Terezë 30-3/6  
KO-10000 Prishtinë  
Telefoni +381 (0) 38 229 874  
[Prishtina@kas.de](mailto:Prishtina@kas.de)  
[www.kas.de/kosovo](http://www.kas.de/kosovo)